



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM
K.P.P. 209/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.05.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” Loti 1 me objekt - “*Blerje bukë gruri dhe simite*” me nr. REF-85664-02-02-2021, me fond limit 19,357,324 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.02.2021, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “M.C.Catering” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: “Kadra” SHPK
Rruga “Nënë Tereza” Laknas, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi Skënderbej, Nr,3, Tiranë

Subjekte të interesuar: “Sinani Trading” SHPK
Lagja “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Iliaz Ahmeti”, magazinë një katëshe, pasuria nr 1957/3, pranë Fabrikës së Qumështit, Lushnje

“M.C.Catering” SHPK
Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga "Budi", Pallati "Rogerd",
Njësia Nr. 33, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.02.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” Loti 1 me objekt - "Blerje bukë gruri dhe simite” me nr. REF-85664-02-02-2021, me fond limit 19,357,324 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.02.2021, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara..

II.2. Në datën 26.02.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 26.03.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

-	“Sinani Trading” SHPK	14 504 402	lekë	I kualifikuar
-	“M.C.Catering” SHPK	15 644 388	lekë	I kualifikuar
-	“Kadra” SHPK	18 596 928	lekë	I kualifikuar

II.4. Në datën 31.03.2021 operatori ekonomik “Kadra” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomik “Sinani Trading” SHPK dhe “M.C.Catering” SHPK me argumentet si më poshtë:

[...] Ne datën 26.03.2021 autoriteti kontraktor "Agjencia e Blerjeve të Përqendruara" publikoi në sistemin e Agjencisë së Prokurimeve Publike" njoftimin e klasifikimit për procedurën: loti 1 – “blerje buke gruri dhe simite” si më poshtë:

NR	OPERATORET EKONOMIKE	VLERAT E OFERTUARA	REFUZUAR
1	SINANI TRADING	14 504 402	JO
2	M.C.CATERING	15 644 388	JO
3	KADRA	18 596 928	JO

Bazuar në nenin 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar përcaktohen parimet e perzgjedhjes së fituesit, citojmë ... "perzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme a) mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”

Gjithashtu mbeshetur në nenin 46, pikë 1 germa "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit publik, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jo diskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë të vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme

teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, paisjet e asetet e tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e e duhur si dhe personelin e nevojshem per te zbatuar kontraten sic eshte pershkruar nga autoriteti ne njoftimin e kontrates;"

Sa me siper cituar bazuar ne ligjin "Per prokurimin publik" operatoret ekonomik "Sinani Trading" dhe "M.C.Catering" SHPK jane kualifikuar ne menyre te padrejte sepse nuk plotesojne disa nga kriteret e vendosura ne kete procedure nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve te Perqendruara. Ne vazhdim po citojme faktet dhe argumentet per secilin nga operatoret e kualifikuar sipas nesh ne menyre te padrejte dhe ne kundersiztim me ligjin "Per prokurimin publik".

Me konkretisht, operatori ekonomik "Sinani Trading" SHPK eshte kualifikuar ne menyre te padrejte sepse:

1- Operatori ekonomik "Sinani Trading" SHPK nuk ploteson kriterin sipas pikes 2.1 kapaciteti ligjor/profesional i operateve ekonomike Pjesa 1, sipas te ciles "operatori ekonomik pjesemarrës duhet te paraqese licence te kategorisë II.1.A.1-prodhim ,përpunim dhe shpërndarje me shumice e ushqimeve per njerez ne emer te tij te leshuar nga qendra kombetare e biznesit. Nisur nga kjo kerkese dhe nga provat e mbledhura madje mendojme qe operatori ekonomik eshte munduar te mashtroje komisionin e vleresimit te ofertave sepse nga vezhgimi ne sistem e vëmë re se të njëjtën licencë me të njëjtin vend të kryerjes se veprimtarise me konkretisht qarku: Korce, rrethi: Korce, B/K: Libonik, QF:Libonik, adresa: rruga qender, nr pasurie 45/79, zona kadastrale 2445 disponohet nga dy emra te ndryshem me konkretisht "Sinani Trading" SHPK dhe "MB kurti" SHPK ne po veme ne dispozicion dy licencat te nxjerra nga sistemi i QKB:

LN-2800-03-2017 data e leshimit 2.03.2017 ne emer te "M.B Kurti" SHPK

LN-2800-03-2017 data e leshimit 24.04.2018 ne emer te "Sinani Trading" SHPK.

Kerkojme nga autoriteti kontraktor rishikimin e dokumentacionit te operatorit ekonomik "Sinani Trading" SHPK per plotesimin e ketij kriteri, pasi sipas dokumenteve te bashkengjitura pervecse nuk e ploteson kriterin e siperpermendur madje eshte munduar të mashtroje ne dokumentacionin e paraqitur ne procedure, duke perdorur licencen II.1.A.1 me dy emra te ndryshem, cka sipas nesh perben shkelje te rende deri ne perjashtim.

2- Operatori ekonomik "Sinani Trading" SHPK nuk ploteson kriterin sipas pikes 2.3 kapaciteti teknik , pika 4 ,shkronja c sipas te ciles "Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te kete ne pronesi ose ne perdorim te pakten (nje) ambient te pershtatshem per prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi me siperfaqe te pakten 50m² për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës si më poshtë:

C- Certifikaten per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Me konkretisht nisur nga hartimi i kriterit nga autoriteti kontraktor agjencia e blerjeve te perqendruara sipas te cilit kjo certifikate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimit eshte vendosur si nenprike e ambientit te pershtatshem per prodhim ose magazinimin duhet qe patjeter kjo certifikate e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi te jete per kete ambient te paraqitur ne kete

procedure. Ky fakt eshte i perforcuar dhe nga vendimi i KPP i marre ne lidhje me nje procedure te njejte te zhvilluar nga po i njejti autoritet kontraktor, per nje operator tjetër i cili gjithashtu kishte paraqitur certifikate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi jo per ambientin e paraqitur ne procedure, me konkretisht:

Vendim K.P.P 55/2021 date 29.01.2021-ankimues "Dajti Park 2007" SHPK kundra vendimit te Agjencise se Blerjeve te Pergendruara.

Gjithashtu fakt tjetër perforcues sipas te cilit certifikata e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi nuk ishte e sakte per ambientin qe ka paraqitur ne kete procedure operatori ekonomik "Sinani trading" SHPK, eshte dhe fakti i licences II.1.A.1 ne te cilen emertimi pershkruet i veprimtarise eshte prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez (furre buke) dhe i kryerjes se veprimtarise eshte qarku Korçe, rrethi Korçe, b/k Libonik, q/f Libonik, adresa rruge qender, nr. pasurie 45/ 79, zona kadastrale 2445, pra nisur nga te dhenat e licences II.1.A.1 rrjedhimisht i bie qe ambienti furre buke qe perfshin kete licence eshte ne adresen e sipercituar dhe duhet qe automatikisht dhe certifikata e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi ti pergjigjet kesaj adrese dhe ketij ambienti. Ne shpresojme fort qe certifikata e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi e paraqitur nga operatori ekonomik "Sinani Trading" SHPK nuk i perket ambientit te paraqitur ne kete procedure.

Bashkengjitur po vendosim vendimin e KPP 55/2021 date 29.01.2021 dhe licencen II.1.A.1 ne emer te "Sinani Trading".

Duke u nisur nga analiza e mesiperme e bazuar dhe ne faktet dhe dokumentet e paraqitura kerkojme nga autoriteti kontraktor rishikimin e dokumentacionit te siperpermendur per plotesimin e ketij kriteri nga operatori ekonomik "Sinani Trading" SHPK.

3- Operatori ekonomik "Sinani Trading" SHPK nuk ploteson kriterin sipas pikes 2.3 kapaciteti teknik, pika 7 sipas te ciles: "Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet te paraqese raport/flete analize fiziko-kimike, leshuar nga nje laborator i references ose i akredituar sipas legjislacionit ne fuqi, jo me heret se 30 dite nga data e zhvillimit te procedures per artikullin: "buke gruri me rreze 70%" sepse ne dijeninë tone ka paraqitur nje raport analize fiziko-kimike nga laboratore privat te paakredituar per te gjitha llojet e analizave qe perfshihen ne fiziko-kimike. Me konkretisht po qartesojme si me poshte autoritetin kontraktor ne lidhje me kete pretendim.

Ne specifikimet teknike shtojca 10 te percaktuara nga autoriteti kontraktor pika 3 e specifikimeve per artikullin "buke gruri me rreze 70% per te cilen kerkohet raport analiza fiziko-kimike, percaktohet qartazi se cilat jane keto analiza qe kerkoehen me konkretisht: treguesit fiziko-kimike

lageshtira ne tul, % jo me shume se 44.5

poroziteti % jo me pak se 72

aciditeti ne grade % jo me shume se 4.5

kripshmeria ne % jo me shume se 2

Kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor percakton qartazi qe raport analiza duhet te permbaje te gjithë treguesit fiziko-kimike nga laborator i references ose i akredituar per keto zera te analizës.

Nese i permbahemi kriterit te vendosur dhe e analizojme atehere gjate investigimit tone dhe ne dijenine tone mjaft te sigurt i vetmi laborator i references ne Shqiperi eshte laborator i shteteror ISUV (Instituti i Sigurise Ushqimore dhe Veterinare), pra ky laborator leshon raport analiza te njohura dhe te pranuar nga te gjitha institucionet e tjera ne bindjen tone te plote operatori ekonomik "Sinani trading" SHPK nuk ka paraqitur raport analize fiziko-kimike nga ky laborator, por raport-analiza e paraqitur nga ky operator ekonomik eshte nga nje laborator privat. Nisur nga fakti i pakundershtueshem dhe siguria e plote e jona qe raport analiza eshte paraqitur nga laboratore private, po ju shtjellojme si me poshte fakte te palekundshme sipas te cilave labororet private jane te paakredituar per te gjitha zerat qe duhet te permbaje raport analiza fiziko-kimike e paraqitur ne kete procedure.

Fillimisht duhet te kujtojme qe labororet privat akreditohen nga Drejtoria e Përgjithshme e akreditimit dhe ky akreditim eshte i vlefshem vetem per listen e analizave qe percaktohet sipas nje tabele standarde te percaktuar nga DPA. Pra per secilin laborator privat ka dhe nje liste analizash per te cilat eshte i vlefshem akreditimi. Gjate kerkimit ne faqen zyrtare te Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit, www.dpa.gov.al gjejme ne faqen kryesore nje dritare ku na del nje liste me te gjitha organet e akredituara nga kjo drejtori. Pas ndjekjes se ketyre hapave veme re qe per ushqimet jane vetem dy laboratore qe jane te akredituar nga DPA, me konkretisht: "Noval Laboratory" SHPK- me nr regjistrimi LT 084 dhe "Bio-V" SHPK- me nr. regjistri LT 105. Ne kete analize po i marrim me rradhe te dy labororet private per tju bere te mundur te kuptoni qe nuk jane te akredituar ne te gjitha zerat qe kerkon raport analiza fiziko-kimike per buke.

Nga faqja web. e Drejtorise së Përgjithshme të Akreditimit www.dpa.gov.al shkarkuam dokumentacionin per laboratorin privat "Noval Laboratory" SHPK ku jane te percaktuara lista e analizave per te cilat eshte i vlefshem akreditimi i leshuar nga DPA per kete laborator privat. "Noval Laboratory" SHPK permban numrin e regjistrimit LT 084. Gjate shqyrtimit te listes se analizave per te cilat eshte i vlefshem ky akreditim, ne u ndalem ne faqen ku eshte percaktuar produkti qe eshte dhe objekt i kesaj procedure (buke.) Ne kete faqe eshte e percaktuar qartazi qe lista e analizave per te cilat eshte i vlefshem akreditimi, me konkretisht per artikullin buke eshte lageshtia ne buke dhe kripshmeria. Po ti rikthehem kriterit te vendosur nga autoriteti kontraktor dhe specifikimeve teknike sipas shtojces 10, pika 3 "buke gruri me rreze 70%", sipas te ciles raport-analiza duhet te permbaje 4 zerat: lageshtire, porozitet, aciditet dhe kripe ,dalim ne perfundimin qe laborator i privat "Noval Ladoratory" SHPK nuk ka akreditim te vlefshem per dy zerat e kerkuara ne raport- analize. Me konkretisht aciditet dhe porozitet. Rrjedhimisht nga keto fakte te parashtruara nje flete-analize e leshuar nga "Noval Laboratory" permban zera te analizës te cilet nuk jane ne listen per te cilen eshte i vlefshem akreditimi dhe rrjedhimisht keto raport-analiza jane të pavlefshme dhe ne kundërshtim me kriterin e siperctuar. Bashkengjitur dhe faqet e siperpermendura te marra nga faqja zyrtare e DPA per "Noval Laboratory" SHPK.

Gjithashtu nga faqja WEB e Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit www.dpa.gov.al shkarkuam dokumentacionin për laboratorin privat "Bio-V" SHPK ku jane te percaktuar lista

e analizave per te cilat eshte i vlefshem akreditimi i leshuar nga DPA per kete laborator privat. "Bio-V" permban numrin e regjistrimit –LT 10. Gjate shqyrtimit te listes se analizave per te cilat eshte i vlefshem ky akreditim ne u ndalem ne listen e analizave per artikullin objekt te kesaj procedure (buke) ose siç e ka te percaktuar ky laborator prodhime brumi per konsum human, me konkretisht:

nr 16 - prodhime brumi per konsum human- salmonela-faqe 4

nr 29 -prodhime hrumi per konsum human- listeria- faqe 6

nr 42- prodhime brumi per konsum human- stafilokoke- faqe 8

nr 55- prodhime brumi per konsum human-npm aerobe- faqe 10

nr 67- prodhime brumi per konsum human-enterobacte-faqe12

nr 79- prodhime brumi per konsum human-escherchiacoli-faqe 14

Në specifikën e ketyre analizave të percaktuara ne listen për të cilën vlen akreditimi duam te theksojme se jane te gjitha analiza mikrobiologjike dhe jo fiziko-kimike. Sic shihet qarte nga keto fakte të parashtruara te vertetuara dhe me dokumentacion perkates laboratori privat "Bio-V" SHPK nuk mund te leshoje analiza fiziko-kimike te vlefshme pasi nuk eshte i akredituar per asnje nga zerat e percaktuar ne kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor dhe te parashikuar ne shtojcen 10 te specifikimeve teknike pika 3 "Buke gruri me rreze 70". Bashkëngjitur gjithashtu dhe faqet e siperpermendura te marra nga faqia e laboratorit privat "BIO-V" SHPK.

Në perfundim te analizës se fakteve te sjella dhe te bashkëngjitura kesaj kerkese kemi arritur te shpjegojme mjaft qarte qe e vetmja analize per artikullin (buke) objekt kesaj procedure qe duhet te pranohet si plotesuese e kriterit eshte analiza fiziki-kimike e leshuar nga laborator shteteror ISUV spese ai eshte i vetmi laborator i references ne Shqiperi. Analizat e leshuara nga laborator privat jane te pavlefshme sepse lista e analizave per te cilat eshte i vlefshem akreditimi i laboreve privat te siperpermendur nuk perfshijne te gjitha zerat e kerkuar ne shtojcen 10 te specifikimeve teknike pika 3 "Buke gruri me rreze 70%". Ne dijeninë tonë dhe ne bindjen tone te plote operatori ekonomik "Sinani Trading" ka paraqitur nje raport-analize nga nje laborator privat dhe rrjedhimisht paraqitja e nje raport analize nga nje laborator privat perben mosplotesim te kriterit te vendosur nga autoriteti kontraktor pasi keta laborator jane te paakredituar.

Nisur nga keto fakte te parashtruara kerkojme nga autoriteti kontraktor rishikimin e dokumentacionit te operatorit ekonomik "Sinani Trading" SHPK per plotesimin e kriterit te sipercituar.

Operatori ekonomik "M.C.Catering" SHPK eshte kualifikuar ne menyre te padrejte sepse:

1-Operatori ekonomik "M.C.Catering" SHPK nuk ploteson kriterin 2.1 kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike pika 1 sipas se ciles "operatori ekonomik pjesemarrës duhet te paraqese licence te kategorise II.1A.1 -prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez". Me konkretisht duke kerkuar ne faqen zyrtare te QKB (Qendra Kombetare e Biznesit) seksionin e licencave veme re qe operatori ekonomik "M.C.Catering" SHPK disponon ne asnjeren prej tyre nuk perfshihet objekti i prokurimit te kesaj procedure per prodhim ose tregtim buke. Operatori ekonomik "M.C.Catering" SHPK ne sistemin e QKB per licencat aktive ka nje paqartësi shume te madhe sepse licencat me te njejtin numer licence

permbajne emertime pershkruese te ndryshme dhe ne sistem jane te emertuara sikur jane të modifikuara, por modifikimi eshte i paqarte. Dyshimet tona jane qe operatori ekonomik "M.C.Catering" te kete perdorur licenca qe ne fakt jane te modifikuara ne nje destinacion tjetër dhe pse ne sistem dalin akoma, ose ky operator mund te kete perdorur nje licence e cila eshte revokuar me veprimtari "furre buke". Me konkretisht do t'ju bashkengjisim licencat me te njejtin numer LN dhe licencen e cila eshte e revokuar ne menyre qe autoriteti kontraktor ti kontrolloje ne sistem.

- LN-0241-09-2009, data e leshimit 04.09.2009, statusi-modifikuar, emertimi pershkrues - i papercaktuar
- LN-0241-09-2009, data e leshimit 03.11.2020, statusi-modifikuar, emertimi pershkrues - restorant dhe sherbime kateringu
- LN-0241-09-2009, data e leshimit 24.12.2020, statusi -aktive, emertimi pershkrues-prodhim, perpunim e shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez.
- LN-0823-02-2010, data e leshimit 02.02.2010, statusi revokuar, emertimi pershkrues-furre buke

Mendojme qe operatori ekonomik "M.C.Catering" SHPK ka perdorur njerën nga licencat e mesiperme ne kete procedure por sic shikohet dhe nga dokumentet e bashkengjitura, ne asnjeren prej tyre nuk ka objektin e prokurimit per prodhim ose tregtim buke dhe licencen qe e ka per "furre buke" e ka te revokuar dhe automatikisht nuk mund te perdoret ne nje procedure sepse jemi ne kushtet e dokumenteve te falsifikuara dhe jane perdorur metoda per te mashtruar komisionin e vleresimit te ofertave. Duam gjithashtu te kujtojmë se ne nje procedure te po se njejtës natyre te kryer nga autoriteti kontraktor agjencia e blerjeve te perqendruara ,operatori ekonomik "M.C.CATERING" u skualifikua nga KVO sepse licencen II.1,A.1 te paraqitur ne procedure nuk e kishte per objektin e prokurimit per prodhim ose tregtim buke. Kjo eshte e publikuar ne buletin e prokurimeve publike me konkretisht buletini nr.17 date 8.02.2021 faqe 174, bashkengjitur kesaj ankese.

Kerkojme nga autoriteti kontraktor rishikimin dokumentacionit te siperpermendur per operatorin ekonomik "M.C.Catering" per plotesimin e ketij kriteri.

- 2- Operatori ekonomik "M.C.Catering", SHPK nuk ploteson kriterin sipas pikes 2.3 kapaciteti teknik, pika 4 ,shkronja c sipas te cilës "operatori ekonomik pjesemarrës duhet te kete ne pronesi ose ne perdorim te pakten 1 (nje) ambient te pershtatshem per prodhimin ose magazinimin e mallra objekt prokurimi me siperfaqe te pakten 50m², per te cilën duhet te paraqesë dokumentacionin perkates si me poshte:

C- Certifikaten per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Me konkretisht nisur nga hartimi i kriterit nga autoriteti kontraktor agjencia e blerjeve te perqendruara sipas te cilit kjo certifikate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimit eshte vendosur si nenpike e ambientit te pershtatshem per prodhim ose magazinim duhet qe patjeter kjo certifikate e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi te jete per kete ambient te paraqitur ne kete procedure. Ky fakt eshte i perforcuar dhe nga vendimi i KPP i marre ne lidhje me nje procedure te njejte te zhvilluar nga po i njejtë autoritet kontraktor;

per nje operator tjeter i cili gjithashtu kishte paraqitur certificate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin jo per ambientin e paraqitur ne procedure, me konkretisht: Vendimi i K.P.P55/2021 date 29.01.2021- ankimues "Dajti Park 2007" SHPK kundra vendimit te Agjencise se Blerjeve te Perqendruara.

Gjithashtu fakt tjeter perforcues sipas te cilit certificate e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi nuk eshte e sakte per ambientin qe ka paraqitur ne kete procedure operatori ekonomik "M.C.Catering" SHPK eshte dhe vendimi i skualifikimit nga po i njejt autoritet kontraktor per nje procedure te njejte me te njejtin objekt prokurimi e pasqyruar ne buletin nr.17 date 8.02.2021 faqe 174 (bashkengjitur), sipas ketij arsyetimi te paraqitur ne buletin per skualifikimin e operatorit ekonomik "M.C.Catering" SHPK, certificate e mbrojtjes kundra zjarrit dhe magazina e paraqitur kane adresa te ndryshme.

Bashkengjitur po vendosim Vendimin e K.P.P 55/2021 date 29.01.2021 dhe pjese nga buletini nr.17 date 08.02.2021 fq(l 73,174,175).

Duke u nisur nga analiza e mesiperme e bazuar dhe ne faktet dhe dokumentet e paraqitura kerkojme nga autoriteti kontraktor rishikimin e dokumentacionit te siperpermendur per plotesimin e ketij kriteri nga operatori ekonomik "M.C.Catering" SHPK.

3- Me konkretisht po qartesojme si me poshte autoritetin Operatori ekonomik "M.C.Catering" SHPK nuk ploteson kriterin sipas pikes 2.3 kapaciteti teknik pika 7 sipas te ciles: "Operatori ekonomik pjesmarres duhet te paraqese raport/flete analize fiziko-kimike, leshuar nga nje laborator i references ose i akredituar sipas legjislacionit ne fuqi, jo me heret se 30 dite nga data e zhvillimit te procedures per artikullin :- buke gruri me rreze 70%" sepse ne dijenine tone ka paraqitur nje raport analize fiziko-kimike nga laborator privat te paakredituar per te gjitha llojet e analizave qe perfshihen ne fiziko-kimike. Autoriteti kontraktor ne lidhje me kete pretendim.

Ne specifikimet teknike shtojca 10 te percaktuara nga autoriteti kontraktor pika 3 e specifikimeve per artikullin "buke gruri me rreze 70%" per te cilen kerkohet raport analiza fiziko-kimike, percaktohet qartazi se cilat jane keto analiza qe kerkohen me konkretisht:

treguesit fiziko-kimike

lageshtira ne tul, % jo me shume se 44.5

poroziteti % jo me pak se 72

aciditeti ne grade % jo me shume se 4.5

kupa ne % jo me shume se 2

Kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor percakton qartazi qe raport analiza duhet te permbaje te gjitha treguesit fiziko-kimik nga laborator i references ose i akredituar per keto zera te analizet.

Nese i permbahemi kriterit te vendosur dhe e analizojme atehere gjate investigimit tone dhe ne dijenine tone mjaft te sigurtë i vetmi laborator i references ne Shqiperi eshte laborator shtetror ISUV (Instituti i Sigurise Ushqimore dhe Veterinare), pra ky laborator leshon

raport analiza te njohura dhe te pranuar nga te gjitha institucionet e tjera. Ne bindjen tone te plote operatori ekonomik "M.C.Catering" SHPK nuk ka paraqitur raport analize fiziko-kimike nga ky laborator, por raport-analiza e paraqitur nga ky operator ekonomik eshte nga nje laborator privat. Nisur nga fakti i pakundershtueshem dhe siguria e plote e jona qe raport analiza eshte paraqitur nga laboratore private, po ju shtjellojme si me poshte fakte te palekundshme sipas te cilave labororet private jane te paakredituar per te gjitha zerat qe duhet te permbaje raport analiza fiziko-kimike e paraqitur ne kete procedure.

Fillimisht duhet te kujtojme qe labororet privat akreditohen nga drejtoria e pergjithshme e akreditimit dhe ky akreditim eshte i vlefshem vetem per listen e analizave qe percaktohet sipas nje tabele standarde te percaktuar nga DPA. Pra per secilin laborator privat ka dhe nje liste analizash per te cilat eshte i vlefshem akreditimi. Gjate kerkimit ne faqen zyrtare te Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit, www.dpa.gov.al gjejmë ne faqen kryesore nje dritare ku na del nje liste me te gjitha organet e akredituara nga kjo drejtori. Pas ndjekjes se ketyre hapave veme re qe per ushqimet jane vetem dy laboratore qe jane te akredituar nga DPA, me konkretisht: "Noval Laboratory" SHPK- me nr. regjistrimi LT 084 dhe "Bio-V" SHPK-me nr. regjistri LT105. Ne kete analize po i marrim me radhe te dy labororet private per tju bere te mundur te kuptoni qe nuk jane te akredituar ne te gjitha zerat qe kerkon raport analiza fiziko-kimike per buke.

Nga faqja web e Drejtorise së Pëgjithshme të Akreditimit www.dpa.gov.al shkarkuam dokumentacionin per laboratorin privat "Noval Laboratory" SHPK ku jane te percaktuara lista e analizave per te cilat eshte i vlefshem akreditimi i leshuar nga DPA per kete laborator privat. "Noval Laboratory" SHPK permban numrin e regjistrimit LT 084. Gjate shqyrtimit te listes se analizave per te cilat eshte i vlefshem ky akreditim, ne u ndalem ne faqen ku eshte percaktuar produkti qe eshte dhe objekti kesaj procedure (buke.) Ne kete faqe eshte e percaktuar qartazi qe lista e analizave per te cilat eshte i vlefshem akreditimi, me konkretisht per artikullin buke eshte lageshtia ne buke dhe kripshtimeria. Po ti rikthehem kriterit te vendosur nga autoriteti kontraktor dhe specifikimeve teknike sipas shtojces 10, pika 3 "buke gruri me rreze 70%" sipas te ciles raport analiza duhet te permbaje 4 zerat: lageshtire, porozitet, aciditet dhe kripe dalim ne perfundimin qe laboratori privat "Noval Ladoratory" SHPK nuk ka akreditim te vlefshem per dy zerat e kerkuara ne raport-analize. Me konkretisht aciditet dhe porozitet. Rrjedhimisht nga keto fakte te parashtruara nje flete analize e leshaur nga "Noval Laboratory" permban zera te analizes te cilet nuk jane ne listen per te cilen eshte i vlefshem akreditimi dhe rrjedhimisht keto raport analiza jane të pavlefshme dhe ne kundershtrim me kriterin e siperctuar. Bashkengjitur dhe faqet e siperpermendura te marra nga faqja zyrtare e dpa per "Noval Laboratory" SHPK.

Gjithashtu nga faqja web e Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit www.dpa.gov.al shkarkuam dokumentacionin për laboratorin privat "Bio-V" SHPK ku jane te percaktuar lista e analizave per te cilat eshte i vlefshem akreditimi i leshuar nga DPA per kete laborator privat. "Bio-V" permban numrin e regjistrimit –LT 10. Gjate shqyrtimit te listes se analizave per te cilat eshte i vlefshem ky akresitim ne u ndalem ne listen e analizave per artikullin objekt te kesaj procedure (buke) ose sic e ka te percaktuar ky laborator prodhime brumi per konsum human, me konkretisht:

nr 16 - prodhime brumi per konsum human- salmonela-faqe 4

nr 29 -prodhime hrumi per konsum human- listeria- faqe 6

nr 42- prodhime brumi per konsum human- stafilokoke- faqe 8

nr 55- prodhime brumi per konsum human-npm aerobe- faqe 10

nr 67- prodhime brumi per konsum human-enterobacte-faqe12

nr 79- prodhime brumi per konsum human-escherchiacoli-faqe 14

Në specifikën e ketyre analizave të percaktuara ne listen për të cilën vlen akreditimi duam te theksojme se jane te gjitha analiza mikrobiologjike dhe jo fiziko-kimike. Sic shihet qarte nga keto fakte të parashtruara te vertetuara dhe me dokumentacion perkates laboratorit privat "Bio-V" SHPK nuk mund te leshoje analiza fiziko-kimike te vlefshme pasi nuk eshte i akredituar per asnje nga zerat e percaktuar ne kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor dhe te parashikuar ne shtojcen 10 te specifikimeve teknike pika 3 "Buke gruri me rreze 70". Bashkëngjitur gjithashtu dhe faqet e siperpermendura te marra nga faqia e laboratorit privat "BIO-V" SHPK.

Në perfundim te analizes se fakteve te sjella dhe te bashkengjitura kesaj kerkese kemi arritur te shpjegojme mjaft qarte qe e vetmja analize per artikullin (buke) objekt kesaj procedure qe duhet te pranohet si plotesuese e kriterit eshte analiza fiziko-kimike e leshuar nga laborator shteteror ISUV sepse ai eshte i vetmi laborator i references ne Shqiperi. Analizat e leshuara nga laborator privat jane te pavlefshme sepse lista e analizave per te cilat eshte i vlefshem akreditimi i laboreve privat te siperpermendur nuk perfshijne te gjithe zerat e kerkuar ne shtojcen 10 te specifikimeve teknike pika 3 "Buke gruri me rreze 70%". Ne dijenine tone dhe ne bindjen tone te plote operatori ekonomik "M.C.Catering" SHPK ka paraqitur nje raport-analize nga nje laborator privat dhe rrjedhimisht paraqitja e nje raport-analize nga nje laborator privat perben mosplotesim te kriterit te vendosur nga autoriteti kontraktor, pasi keta laborator jane te paakredituar.

Nisur nga keto fakte te parashtruara kerkojme nga autoriteti kontraktor rishikimin e dokumentacionit te operatorit ekonomik "M.C.Catering" SHPK per plotesimin e kriterit te sipercituar.

Nisur nga te gjitha argumentimet dhe arsyetimet bazuar dhe ne provat e sjella dhe te bashkengjitura kesaj ankese, mendojme qe autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve te Perqendruara duhet te rishikojte kualifikimin e operatoreve ekonomik "Sinani Trading" SHPK dhe "M.C.Catering" SHPK dhe duhet te vleresoje oferten qe permbush ne menyre te plote cdo kerkese dhe kriter te vendosur ne dokumentet standarde te kesaj procedure.

Bazuar gjithashtu ne nenin 46, pika l germa "b" te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operoret ekonomike per te marre pjese ne procedurat e prokurimit publik, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jo diskriminuese. b) aftesia teknike: operoret ekonomike te vertetojne se zbatojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asetet e tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur si dhe personelin e nevojshem per te zbatuar kontraten sic eshte pershkruar nga autoriteti ne njoftimin e kontrates;"

Gjithashtu ne zbatim te kerkesave te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar, VKM nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" dhe DST kerkojme:

- 1- Rishikimin e dokumenteve te sipercituara per operatorin ekonomik "Sinani Trading" SHPK
- 2- Rivleresimin e ofertave dhe skualifikimin e operatorit ekonomik "Sinani Trading" SHPK.
- 3- Rishikimin e dokumenteve te sipercituara per operatorin ekonomik "M.C.Catering" SHPK
- 4- Rivleresimin e ofertave dhe skualifikimin e operatorit ekonomik "M.C.Catering" SHPK"

II.6. Në datën 07.04.2021 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur mospranimin e ankesës për pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik "Sinani Trading" SHPK, ndersa pretendimet e ankimuesit lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik "M.C.Catering" SHPK nuk janë marrë në shqyrtim me arsyetimin se" ...Për sa kohë pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, operatori ekonomik "Sinan Trading" SHPK përmbush kriteret e kualifikimit për të cilat ngre pretendime ankimuesi dhe gjendja e tij faktike juridike pas Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve te ankimuesit në lidhje me kualifikimin e ofertuesit "M.C.Catering" SHPK nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes..... Për këtë arsye këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim."

II.7. Në datën 14.04.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtat pretendime që ka paraqitur në Autoritet Kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.803 prot., datë 27.04.2021 protokolluar me tonën me nr. 599/2 prot datë 29.04.2021 me objekt "Dërgim informacioni dhe dokumentacioni për lotin 1 "Blerje bukë gruri dhe simite" për procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje artikuj ushqimorë" e ndarë në 5 (pesë) lote", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Kadra" SHPK mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Sinani Trading" SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se: "Operatori ekonomik "Sinani Trading" SHPK nuk ploteson kriterin sipas pikes 2.3 kapaciteti teknik, pika 7 sipas te ciles:"Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te paraqese raport/flete analize fiziko-kimike, leshuar nga nje laborator i references ose i akredituar sipas legjislacionit ne fuqi, jo me heret se 30 dite nga data e zhvillimit te procedures per artikullin: "buke gruri me rreze 70%" sepse ne dijenine tone ka paraqitur nje raport analize fiziko-kimike nga laborete privat te paakredituar per te gjitha llojet e analizave qe perfshihen ne fiziko-kimike." Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9, Loti 1 “Blerje bukë gruri dhe simite”, “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, 2.3 “*kapaciteti teknik*” pika 7 të dokumenteve të tenderit, është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë:

*Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Raport/ Fletë Analizë Fiziko-Kimike, lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi, jo më herët se 30 ditë nga data e zhvillimit të procedurës, për artikullin:
Bukë gruri me rreze 70%.*

III.1.2. Në shtojcën 10 të dokumenteve të tenderit “Specifikimet teknike”, Loti 1, “Bukë gruri + simite” pika 3 përcaktohen specifikimet teknike si më poshtë:

3. BUKË GRURI ME RREZE 70 %

Bazuar ne SSH 1411:1987 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi:

- *Bukë me miell gruri me rreze 70 %*

Karakteristikat cilësore:

Treguesit shqisorë:

- *Korja*: E lëmuar, pa djegie e pa shkëputje të saj nga tuli. Me ngjyrë të njëlojtë mjalti në të kuqerremtë.
- *Tuli*: Masa e njëlojtë e pjekur mirë, jo e ngjitshme, me pore të shpërndara në mënyrë të njëlojtë, dhe pa gjurmë mielli të pabrumosur. Konsistenca elastike, me shtypje të lehtë rikthehet në gjendjen e mëparshme.
- *Era dhe shija*: E këndshme. Nuk lejohet kërcitje.
- *Lëndët e huaja*: Nuk lejohen.

Treguesit fiziko-kimik:

- *Lagështira në tul*, % jo më shumë se 44.5.
- *Poroziteti në %* jo më pak se 72.
- *Aciditeti në gradë* jo më shumë se 4.5.
- *Kripa në %* jo më shumë se 2.

Ambalazhimi dhe marketimi: Bazuar në SSH 1494:1987 ose ekuivalentin e tij.

Çdo bukë të futet në qese letre me masën e përcaktuar sipas AK, këto të futura në kuti kartoni, druri ose plastike që të jenë të pastra dhe të mos lejojnë shtypjen e bukës. Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes. Lejohen mënjanimet nga masa e caktuar $\pm 3\%$, për çdo bukë.

Ruajtja dhe transportimi: Bazuar në SSH 1494:1987 ose ekuivalentin e tij.

Buka e pjekur ruhet në mjedise të pastra, të ajrosura, e pa lagështirë, dhe të dezinfektuara nga dëmtuesit e ndryshëm. Koha e ruajtjes në këto kushte është deri në 48 orë.

Bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Buka duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.
Raport-analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.
Raport-Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

4. BUKË GRURI ME RREZE 70 %

Bazuar në SSH 1411:1987 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi:

- *Bukë me miell gruri me rreze 70 %*

Karakteristikat cilësore:

Treguesit shqisorë:

- *Korja:* E lëmuar, pa djegie e pa shpëputje të saj nga tuli. Me ngjyrë të njëjlojtë mjalti në të kuqerremtë.
- *Tuli:* Masa e njëjlojtë e pjekur mirë, jo e ngjitshme, me pore të shpërndara në mënyrë të njëjlojtë dhe pa gjurmë mielli të pabrumosur. Konsistenca elastike, me shtypje të lehtë rikthehet në gjendjen e mëparshme.
- *Era dhe shija:* E këndshme. Nuk lejohet kërcitje.
- *Lëndët e huaja:* Nuk lejohen.

Treguesit fiziko-kimik:

- *Lagështira në tul, %* jo më shumë se 44.5.
- *Poroziteti në %* jo më pak se 72.
- *Aciditeti në gradë* jo më shumë se 4.5.
- *Kripa në %* jo më shumë se 2.

Ambalazhimi dhe marketimi: Bazuar në SSH 1494:1987 ose ekuivalentin e tij.

Çdo bukë të futet në qese letre me masën e përcaktuar sipas AK, këto të futura në kuti kartoni, druri ose plastike që të jenë të pastra dhe të mos lejojnë shtypjen e bukës. Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes. Lejohen mënjanimet nga masa e caktuar $\pm 3 \%$, për çdo bukë.

Ruajtja dhe transportimi: Bazuar në SSH 1494:1987 ose ekuivalentin e tij.

Buka e pjekur ruhet në mjedise të pastra, të ajrosura, e pa lagështirë, dhe të dezinfektuara nga dëmtuesit e ndryshëm. Koha e ruajtjes në këto kushte është deri në 48 orë.

Bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Buka duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara
III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) në përmbushje të kritereve të mësipërme, operatori ekonomik ”Sinani Trading” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Certifikatë analize nga laboratori "Noval Laboratory" i lëshuar me datë 18.02.2021, për operatorin ekonomik "Sinani Trading SHPK" për kategorinë e produkti "Drithera dhe nën Produkte" me përshkrim kampioni " Bukë gruri rreze mielli 70% pesha 1000 gr" për parametrat;*
- *Kripshmeria, Lagështia, Aciditeti, Poroziteti, Pesha e bukës;*
- *treguesit shqisorë (pamja e jashtme, ngjyra, era dhe shija, forma e bukes, korja, tuli i bukes, struktura dhe konsistenca);*
- *Lëndët e huaja*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se : *"[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;"*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...."*

III.1.4. Në nenin 30 të VKM nr. 914 dt.29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar parashikohet se *"Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit."*

III.1.5. Ne Urdhrin e Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nr.524, date 23.09.2019, është përcaktuar si me poshtë:

Ne mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe në zbatim të nenit 44, pika 1 dhe nenit 59, pikat 1 dhe 9, shkronja "a", të ligjit nr. 9863, date 28.1.2008 "Për ushqimin", të ndryshuar, URDHEROJ:

1. Autorizimin e "Noval Laboratory", me NIPT: L81904506I, si laborator të autorizuar për kryerjen e analizave laboratorike të mostrave të marra gjatë kontrollit zyrtar, për llojin e analizave, sipas shtojcës I, bashkelidhur këtij urdhri, deri me datë 25.11.2022.

2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdher hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTER I BUJQESISE
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Bledar Cuci

SHTOJCA I

<i>Produkti</i>	<i>LLOJI I ANALIZËS</i>	<i>TEKNIKA E PROVËS</i>
<i>Vajra</i>	<i>Përcaktimi i aciditetit</i>	<i>Titullim</i>
	<i>Numri i peroksideve</i>	
	<i>Delta K</i>	<i>Spektrofotometer</i>
<i>Ushqime: Fruta te thata</i>	<i>Numërim i maja dhe myqe</i>	<i>Numërim në pjatë</i>
<i>Ushqime me bazë brumi dhe nënprodukteve të saj</i>	<i>Numërim i maja dhe myqe</i>	<i>Numërim në pjatë</i>
<i>Ushqim gati për konsum human</i>	<i>Numërim i kolonive bakteriale në 30°C</i>	<i>Numërim në pjatë</i>
<i>Ushqime fruta dhe perime të freskëta</i>	<i>Numërim i Escherichi Coli, beta-glukoronidasi pozitive</i>	<i>Numërim në pjatë</i>
<i>Ushqime me bazë mish dhe nënproduktet e saj</i>	<i>Numërim i Escherichi Coli, beta-glukoronidasi pozitive</i>	<i>Numërim në pjatë</i>
<i>Ushqime me bazë veze dhe nënprodukte të saj</i>	<i>Kërkimi i salmonella spp</i>	<i>Kërkim në pjatë</i>
<i>Ushqime të përpunuara gati për konsum human</i>	<i>Kërkimi i listeria monocytogenes</i>	<i>Kërkim në pjatë</i>

III.1.6. Nga verifikimi i kryer rezulton se, laborator i testues “Noval Laboratory”, i cili ka lëshuar certifikatën e analizës për analizimin e produktit “*Bukë gruri rreze mielli 70% pesha 1000 gr*”, është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, me anë të certifikatës me numër regjistrimi LT 084 26.11.2018. Nga shqyrtimi i listës së analizave për të cilat është i vlefshëm akreditimi, Komisioni konstaton, se ky laborator është i akredituar për të kryer analiza laboratorike, për prodhime drithërash, bukë, makarona etj., në të cilat nuk përfshihen analizat e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa i përket porozitetit dhe aciditetit por vetëm ato në lidhje me kripshmërinë dhe lagështinë.

III.1.7. Autoriteti Kontraktor në lidhje me këtë pretendim ka kthyer përgjigje duke argumentuar se: “[...] Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në procesverbalin nr.3 datë 25.03.2021 “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave” Loti 1 “Blerje buke gruri dhe simite” për sa i përket kualifikimit të ofertuesit “Sinani Trading” SHPK lidhur me pikën 7 në seksionin 2.3 “kapaciteti teknik” në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” në dokumentet e tenderit është shprehur: Ndërsa për sa i përket fletë-analizave fiziko-kimike të paraqitura nga “M.C.Catering” SHPK dhe “Sinani Trading” SHPK dy anëtarët e KVO i konsiderojnë ofertat e tyre të vlefshme pasi e konsiderojnë devijim të vogël faktin se Laboratori Noval nuk është i akredituar për analizimin e “Aciditetit dhe porozitetit” të bukës. Kjo pasi së pari fletë-analiza fiziko-kimike në këtë fazë të procedurës nuk shoqëron mallin që do të furnizohet (sipas specifikimeve teknike, verifikimi i kërkesave cilesore, buka do të shoqërohet me raport-analizë të rregullt në momentin e furnizimit të saj) por është për të krijuar një panoramë të qartë mbi operatorin ekonomik ofertues dhe së dyti, ndonëse ky laborator nuk është i akredituar për këta tregues përsëri treguesi fiziko-kimik për aciditetin dhe porozitetin e bukës që tregohet nga këta operatorë ekonomik janë brenda parametrave të kërkuara në DST. Pra nuk ndryshohen thelbësisht karakteristikat dhe kërkesat e përcaktuara në DST. Për këtë dy anëtarët e KVO bazohen në nenin 53 pika 4 të LPP

sipas të Cilit: Autoriteti Kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme dhe nëse ajo përmban devijime të vogla të argumentuara të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit si dhe gabime shtypi të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj” si dhe rekomandimet e KLSH mars 2020 e cila shprehet se: “... për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore, ABP mund të tregohet më tolerante duke i konsideruar mangësitë (rastet kur nuk plotësohen disa kërkesa të vecanta të vendosura në DT) si devijime të vogla” Gjithashtu në shtojcën nr. 12 ‘Sasia dhe grafiku i lëvrimit’ përcaktohet se: “Verifikimi i kërkesave cilësore: Buka duhet të shoqërohet me raport-analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi. Raport-analiza duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. Për arsyet e mësipërme pretendimi i ofertuesit “Kadra” nuk pranohet”.

III.1.8. Sa më sipër rezulton se laborator testues “Noval Laboratory”, i cili ka lëshuar certifikatën e analizës për produktin “Bukë gruri rreze mielli 70% pështa 1000 gr” për operatorin ekonomik “Sinani Trading” SHPK është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, me anë të certifikatës me numër regjistrimi LT 084 26.11.2018. Nga shqyrtimi i listës së analizave për të cilat është i vlefshëm akreditimi, Komisioni konstaton se ky laborator është i akredituar për të kryer analiza laboratorike për prodhime drithërash, bukë, makarona etj., por në këto analiza nuk përfshijnë analizat e kërkuara nga autoriteti kontraktor lidhur me porozitetin dhe aciditetin, pavarësisht se ka lëshuar raport-analizë për produktet e kërkuara përfshirë edhe porozitetin dhe aciditetin e bukës. Në rastin konkret Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK, nuk ka paraqitur dëshmi të rezultateve të testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuara dhe të akredituara të kontrollit ose referencës, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, për këta dy tregues, pasi ky laborator nuk është i akredituar për analizen Fiziko-Kimike të aciditetit dhe porozitetit për artikullin në fjalë. Gjithashtu rezulton se referuar Shtojcës 1, të Urdhrit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nr.524, datë 23.09.2019, laborator testues “Noval Laboratory”, nuk është laborator i referencës për analizën e Aciditetit dhe Porozitetit të bukës, por është laborator i referencës për numërimin e Majasë dhe Myqeve në bukë, e për pasojë ndodhemi në kushtet e mospërmbushjes të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.7, të shtojcës 9 “Kapaciteti teknik”, në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Komisioni thekson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e

operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në këte kuadër duke qenë se operatori ekonomik “Sinani Trading” nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit KPP e gjykon të pabazuar vendimin e autoritetit kontraktor për kualifikimin e këtij operatorit ekonomik në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Kadra ” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Kadra” SHPK mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm qëndron dhe gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK pas arsyetimit të K.P.P-së do të ndryshojë duke u skualifikuar si dhe duke përmbushur interesin e ankimuesit, pretendimet të tjera nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Kadra” SHPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “M.C.Catering” SHPK me pretendimin se “*Operatori ekonomik "M.C.Catering" SHPK nuk plotëson kriterin sipas pikës 2.3 kapaciteti teknik pika 7 sipas të cilit: "Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë raport/fletë analize fiziko-kimike, lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi, jo më heret se 30 dite nga data e zhvillimit të procedurës për artikullin : - buke gruri me rreze 70%" sepse në dijeninë tone ka paraqitur një raport analize fiziko-kimike nga laborator privat të paakredituar për të gjitha llojet e analizave që përfshihen në fiziko-kimike.*” KPP vëren se, III.3.1 Në shtojcën 9, Loti 1 “Blerje bukë gruri dhe simite”, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, 2.3 “kapaciteti teknik” pika 7 të dokumenteve të tenderit, është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë:

*Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **Raport/ Fletë Analizë Fiziko-Kimike**, lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi, jo më heret se 30 ditë nga data e zhvillimit të procedurës, për artikullin:*

Bukë gruri me rreze 70%.

III.3.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) në përmbushje të kriterëve të mësipërme, operatori ekonomik ”Sinani Trading” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Certifikatë analize nga laboratorin ”Noval Laboratory” i lëshuar me datë 18.02.2021, për operatorin ekonomik ”M.C.Catering” për kategorinë e produktit ”Drithra dhe nën Produkte” me përshkrim kampioni ” Bukë gruri rreze mielli 70% peshë 1000 gr” për parametrat;*
- *Kripshmeria, Lagështia, Aciditeti, Poroziteti, Peshë e bukës;*
- *treguesit shqisorë (pamja e jashtme, ngjyra, era dhe shija, forma e bukes, korja, tulli i bukes, struktura dhe konsistenca);*
- *Lëndët e huaja*

III.3.3. Autoriteti Kontraktor në lidhje më këtë pretendim ka kthyer të njëjtën përgjigje si për operatorin ekonomik “Sinani Trading” SHPK të pasqyruar në pikën III.1.7 të këtij vendimi.

III.3.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit....*”.

III.3.5. Në nenin 30 të VKM nr. 914 dt.29.12.2014 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se “*Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*”

III.3.6. Nga verifikimi i kryer rezulton se është i njëjti laborator testues “Noval Laboratory”, i cili ka lëshuar certifikatën e analizës për analizën e produktit “Bukë gruri rreze mielli 70% pesha 1000 gr”, për operatorin ekonomik “M.C.Catering” SHPK, i cili sic kemi theksuar më sipër është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, me anë të certifikatës me numër regjistrimi LT 084 26.11.2018 për të kryer analiza laboratorike, për prodhime drithërash, bukë, makarona etj., por në listën e analizave për të cilat është akredituar nuk përfshihen analizat e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa i përket porozitetit dhe aciditetit, por vetëm ato në lidhje me kripshmërinë dhe lagështinë.

III.3.7. Në këtë mënyrë, Komisioni gjykon se edhe operatori ekonomik “M.C.Catering” SHPK, nuk ka paraqitur dëshmi të rezultateve të testeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuara dhe të akredituara të kontrollit ose referencës, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, për këta dy tregues (porozitetin dhe aciditetin), pasi ky laborator nuk është i akredituar për analizen Fiziko-Kimike të aciditetit dhe porozitetit për artikullin në fjalë. Gjithashtu siç kemi përmendur në pikën III.1.8 të këtij vendimi bazuar në Shtojcën1, të Urdhrit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nr.524, date 23.09.2019, laborator testues “Noval Laboratory”, nuk është laborator i referencës për analizën e Aciditetit dhe Porozitetit të bukës, por është laborator i referencës për numërimin e Majasë dhe Myqeve në bukë, e për pasojë ndodhemi në kushtet e mospërmbushjes nga ana e operatorit ekonomik “M.C.Catering” SHPK të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.7, të shtojcës 9 “Kapaciteti teknik”, në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Komisioni thekson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për

përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në këtë kuadër duke qenë se operatori ekonomik “M.C.Catering” SHPK nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit KPP e gjykon të pabazuar vendimin e autoritetit kontraktor për kualifikimin e këtij operatorit ekonomik në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Kadra ” SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Kadra” SHPK mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “M.C.Catering” SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm qëndron dhe gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “M.C.Catering” SHPK pas arsyetimit të K.P.P-së do të ndryshojë duke u skualifikuar si dhe duke përmbushur interesin e ankimuesit, pretendimet të tjera nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kadra” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” Loti 1 me objekt - "Blerje bukë gruri dhe simite” me nr. REF-85664-02-02-2021, me fond limit 19,357,324 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.02.2021, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së datë 26.03.2021 mbi kualifikimin e operatorëve ekonomik “Sinani Trading” SHPK dhe “M.C.Catering” SHPK duke i skualifikuar këta operatorë ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kadra” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.599 Protokoli, Datë 14.04.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri